



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhornii Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 762/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala, dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Tahir Çaka, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Kaçanik, paraqitur kundër publikimit të raportit preliminar të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejueshme ankesa e Tahir Çaka, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Kaçanik

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 07.11.2013, nga Tahir Çaka, nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Kaçanik, në të cilën dyshon se në komunën e Kaçanikut në shumë vendvotime është manipuluar me rezultate dhe se dyshimi vjen si nga qytetarët ashtu edhe nga anëtarët e AAK-së se nuk është ky rezultat që është shpallur, andaj parashtruesi i ankesës mendon se ndryshe është rezultati nëpër fletëvotime dhe ndryshe është shkruar në FPR dhe FRK . Qendrat e votimit në të cilat dyshohet se ka manipulime janë: 0701D (Me 7 vendvotime) 0701X (Me 8 vendvotime) 0705D (Me 2 vendvotime) 0706D (Me 4 vendvotime) 0707D (Me 4 vendvotime) 0703D (Me 2 vendvotime) 0702D (Me 2 vendvotime) 0704D (Me 2 vendvotime) 0713D (Me 2 vendvotime) 0711D (Me 2 vendvotime)

Andaj parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i që të rinumërohen të gjitha këto kuti nga vendvotimet si për kryetar të komunës ashtu edhe kutitë për asamble komunale, pasi që dyshojnë se është bërë manipulime të ndryshme si për fletëvotimet për kryetar komune ashtu edhe për asamble komunale, pasi që diçka tjetër është nëpër fletëvotime e diçka tjetër është shkruar nëpër FRP dhe FRK dhe si shembull marrin një kandidatë për kuvend komunal e cila ka votuar në qendren e votimit 0704d në fshatin Ngucay dhe të cilës nuk i

ka dalë as vota e saj dhe si dëshmi kanë bashkangjitur edhe deklaratën e kandidates dhe FRK e cila nuk e ka asnjë votë në këtë qendër te votimit.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrahet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se “Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve te vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrroi ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim te nenit 118.1 te LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat te cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 te Rregullave dhe Procedurave te PZAP-it, ne të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund ti hidh poshtë (si te palejuar, të parregullta apo te pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat te cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si ne dispozitiv te ketij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 762/2013 më datën 08.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.